

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Balla u drejtohet europarlamentarëve në Tiranë: Vëreni në krye të agjendës ratifikimin e aderimit të Shqi përisë në BE                                                                                                                                                                                                        |
| ADRESA  | <a href="https://prapaskena.com/2026/09/28/balla-u-drejtohet-europarlamentareve-ne-tirane-vereni-ne-krye-te-agjendes-ratifikimin-e-aderimit-te-shqiperise-ne-be/">https://prapaskena.com/2026/09/28/balla-u-drejtohet-europarlamentareve-ne-tirane-vereni-ne-krye-te-agjendes-ratifikimin-e-aderimit-te-shqiperise-ne-be/</a> |
| BURIMI  | prapaskena.com                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 28 shtator 2026, 13:07:25 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 12:50:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                   |
|------------|-------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 875d7d0fcea44a2f99192833ff4553f80543a62443c36d134533fbab45f3814c5 |
| TEKSTI     | 3eb8267abeafa874a4eee80c319b07dfc1f8be771a73c60cd7b17ccc21dba991  |
| PAMJA      | 878829be52df818d0fbec2afc187ec9735620e5a69a7fcd231e4f18a01eb7460  |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | a95c0a25c63220afcb0827140a52fa2e0661759302094f516ec54a4481dbc26a                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a95c0a25c63220afcb0827140a52fa2e0661759302094f516ec54a4481dbc26a>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Balla u drejtohet europarlamentarëve në Tiranë: Vëreni në krye të agjendës ratifikimin e aderimit të Shqipërisë në BE

Politikë

Publikuar: 28/09/2026

f X



**K**ryetari i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, Taulant Balla e cilësoi reformën në drejtësi një nga dëshmitë më domethënëse të përparimit të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Duke folur në Konferencën Ndërparlamentare për zgjerimin e BE-së dhe anëtarësimin e Shqipërisë, ai tha se ndryshimet kushtetuese dhe institucionet e krijuara prej reformës i kanë dhënë sistemit të drejtësisë mundësinë të hetojë, të ndjekë penalisht dhe të gjykojë edhe zyrtarë të niveleve të larta.

Sipas Ballës, sfida e Shqipërisë para reformës nuk ishte vetëm korrupsioni, por edhe mungesa e institucioneve të pavarura e të fuqishme për ta luftuar atë. Ai tha se sistemi i mëparshëm nuk kishte kapacitetin e nevojshëm për të vepruar kur dyshimet përfshinin individë me pushtet politik ose publik.

“Tani Shqipëria ka institucione të drejtësisë me pavarësinë për të hetuar, për të ndjekur penalisht dhe për të gjykuar, edhe kur rastet kanë të bëjnë me individë që mbajnë poste të larta politike apo publike”, u shpreh Balla..

Ai vlerësoi se drejtësia ka sot kapacitete që i mungonin prej kohësh, përfshirë mundësinë për t’iu përgjigjur shkeljeve dhe për të korrigjuar problemet brenda sistemit.

Kreu i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri tha se mbështetja për institucionet e pavarura të drejtësisë dhe strukturat e specializuara kundër korrupsionit duhet të jetë e

## Me të lexuarat

-  Nga Hati tek prokurori i SPAK, personazhet në videot e Gys (Agjencitë e media e vëllezërve Veshaj që i blenë Fidel Yllit për 300 mijë euro, biznesmenia të patmenat e fjetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare. Parajmërimi tronditës i Bill Gates: Inteligjenca Artificiale mund të vrasë 1 miliard njerëz
-  Ramës pas akuzave të SPAK për zyrtarët pranë tij: Korrupsioni po goditet, nuk ...

palëkundur, pavarësisht kostos politike apo nivelit të pushtetit të personave të përfshirë.

Në të njëjtën kohë, ai nënvizoi se pavarësia e drejtësisë duhet të ushtrohet brenda kufijve të Kushtetutës dhe në respekt të të drejtave të njeriut. Sipas tij, prezumimi i pafajësisë, procesi i rregullt ligjor, fshehtësia e hetimit dhe dinjiteti njerëzor duhet të mbeten në qendër të veprimtarisë së institucioneve.

Për këtë arsye, Balla tha se faza e ardhshme e reformës duhet të përqendrohet te konsolidimi i sistemit dhe ngritja e standardeve, duke garantuar njëkohësisht zbatimin e standardeve kushtetuese dhe evropiane për mbrojtjen e të drejtave individuale. “Po ndërtojmë një sistem ku askush nuk është mbi ligjin dhe askush nuk është jashtë mbrojtjes së ligjit”, u shpreh ai.

Balla tha se Shqipëria synon të përmbyllë negociatat e anëtarësimit deri në Krishtlindjet e vitit të ardhshëm, objektiv që e cilësoi ambicioz. Ai kërkoi mbështetjen e parlamenteve të vendeve të BE-së për ratifikimin në kohë të traktatit të aderimit dhe u bëri thirrje që çështja të mos lihet në fund të agjendave parlamentare.

Fjala e plote

Faleminderit, i nderuar kryetar, të nderuar kolegë.

Mirë se erdhët në Shqipëri.

Teksa po prisja sesionin e sotëm, po flisja me disa kolegë të cilët kishin fluturim direkt për në Tiranë.

Dhe kjo është diçka e shkëlqyer që tregon ndërlidhjen që është përmirësuar.

Sigurisht që ne synojmë të kemi fluturime direkte me secilin nga 27 kryeqytetet e BE-së, por dua të filloj së pari, duke ndarë me ju disa të dhëna kuptimplote për Aeroportin e Tiranës. Në 2013 ne kishim vetëm 1,75 milionë pasagjerë në vit.

Ndërsa vetëm në gusht të 2026-ës kemi pasur 1,8 milionë pra të gjithë pasagjerët e 2013-ës.

Gjithë ky numër u tejkalua vetëm me shifra të gushtit 2026 dhe i gjithë viti 2026 parashikohet të shkojë përtej 13,3 milionë pasagjerë që fluturojnë përmes Aeroportit të Tiranës dhe shpresojmë që vitin tjetër të kemi aeroportin e dytë në Vlorë dhe numrat do të rriten edhe më tej.

Kjo e ka bërë Tiranën kryeqytetin e Ballkanit Perëndimor dhe jemi krenarë me këtë fakt.

Teksa po përgatisja disa mendime për të ndarë me ju në këtë takim të sotëm po i hidhja një sy anketës, sondazhit të fundit të bërë nga Instituti Ndërkombëtar Republikan dhe i publikuar në korrik. 96 për qind e shqiptarëve do të votonin në një referendum pro bashkimit me BE-në, nëse referendumi do të bëhej tani. 96 për qind është përkrahja dhe mbase 4 për qind nuk e kuptojnë pyetjen.

Kjo është diçka e shkëlqyer.

Dhe diçka tjetër që flet shumë

dhe agjenda gjatë që në bashkëpunim.

Ky sondazhi u publikua nga Euronews. 96 për qind e shqiptarëve e mbështesin Ukrainën, vetëm 2 për qind mbështesin Rusinë dhe këtu besoj se e njëjta gjë, nuk e kuptojnë pyetjen.

99 për qind e shqiptarëve nuk e pëlqejnë Vladimir Putinin dhe 1 për qind nuk e njeh.

Këto shifra ju tregojnë shumë për vendin tonë.

Më lejoni t'ju them se jemi në një moment shumë deciziv.

Jemi shumë krenarë që flasim për një BE zgjeruar dhe kanë kaluar shumë vite që nga zgjerimi i fundit i fundit.

Unë isha në Kroaci në korrik 2013, së bashku me kryeministrin Rama, që sapo ishte emëruar si kryeministër i Shqipërisë, pasi fituam zgjedhjet në qershor 2013. Nuk më besohej që do të duhej një kohë kaq e gjatë për një tjetër zgjerim të BE-së.

Në 2003-shin kam qenë në Samitin e Selanikut dhe gjatë darkës patëm një doli të ngrohtë me miqtë tanë me George Papandreu, i cili tha që shpresojmë që BE-ja të bëhet anëtare e BE-së brenda 20 viteve, por tashmë kanë kaluar 20 vite dhe 23, por kjo nuk është vetëm në dorën tonë, prandaj ju kemi ftuar juve gjithëve, të diskutojmë me kryetarin e Kuvendit, kryetarin e kryeministrin që të mbledhemi këtu bashkë në Tiranë, që të ndajmë me ju idetë.

E di që vendimi për ratifikimin e Traktatit të Aderimit të Shqipërisë në BE do të kalojë në kuvend, në parlament tuaj. Shpresoj dhe besoj që ndonjë vend të mos kalojë në referendum dhe të miratohet në parlament.

Dhe ne kërkojmë mbështetjen tuaj që kjo të ndodhë në kohën e duhur, pa vonesa.

Agjenda jonë është e që ne planifikojmë që të përmbylлим negociatat brenda Krishtlindjeve të vitit që vjen dhe pastaj do të jetë në dorën tuaj, puna juaj që ta kaloni në parlament tuaj.

E dimë që është një objektiv ambicioz, por përparimi i arritur deri tani ka demonstruar se, kur reformat mbështeten nga vullneti politik, nga kapacitetet institucionale dhe sigurisht nga një perspektivë e besueshme evropiane, e di që mund të ecim përpara me një ritëm të shpejtë.

Sfida tani është që të ruajmë këtë ritëm, sepse sa më shumë i afrohemi përmbylljes së negociatave, aq më kërkuese, sfiduese bëhet puna. Ne po zhvendosemi nga një proces i fokusuar tek hapja e grupkapitjeve, kryesisht tek përafrimi i legjislacionit, në një proces ku theksi është gjithnjë e më tepër tek zbatimi, tek qëndrueshmëria e reformave dhe sigurisht tek rezultatet e prekshme.

Në këtë fazë, nuk është më e mjaftueshme që një ligj është miratuar, apo që ajo pjesë e Acquis-ë për shembull, është transpozuar. Ne duhet të demonstrojmë që ligjet të zbatohen, që institucionet të funksionojnë në mënyrë efektive, dhe që të realizohen rezultate konkrete, dhe mbi të gjitha, që qytetari ynë ta ndjejë ndryshimin.

Prandaj, procesi i aderimit vazhdon të jetë katalizatori më i rëndësishëm, më i fuqishëm për vendin tonë. Ne besojmë te ky proces 100%, dhe është pothuajse tërësisht komplet e qartë, sepse ne, Shqipëria, nuk kemi një plan B; kemi vetëm planin A, të bashkohemi me Bashkimin Evropian.

Dhe nëse duam të kuptojmë progresin real të Shqipërisë, duhet të shohim vetëm te grupkapitujt që kemi hapur dhe mbyllur, por duhet të shohim edhe institucionet që kemi ndërtuar dhe mënyrën se si ato funksionojnë. Një nga shembujt më domethënës të rezultateve tona është reforma në drejtësi.

Janë më shumë se 10 vjet që kur e morëm vendimin dhe votuam në parlament për këtë reformë, si dhe ndryshimet kushtetuese që i hapën rrugën reformës në drejtësi. Dhe, nëse e kthejmë kokën pas, pas 10 vitesh, për Shqipërinë sfida nuk ka qenë vetëm lufta kundër korrupsionit, por problemi ka qenë edhe mungesa e një sistemi institucional me pavarësinë e duhur dhe me fuqinë e duhur për ta luftuar korrupsionin, përfshirë rastet kur kishte edhe dyshime tek individët që ushtronin pushtet politik publik.

Sot kemi një realitet tjetër: sot Shqipëria ka institucione të drejtësisë me pavarësinë që të hetojnë, të ndjekin penalisht dhe të gjykojnë, sidomos edhe kur rastet kanë të bëjnë me individë që mbajnë poste të larta politike, publike, apo ato që kanë lidhje me pushtetin politik.

Kur ishim gati për të votuar për reformën në drejtësi në 2016-ën, dhe unë personalisht kisha përvojë personale, sepse kam përfunduar studimet në Rumani, edhe atje filluan me ADN, nuk është ADN aktualisht, por është. Kanë filluar me departamentin për luftën kundër korrupsionit, kështu quhej Shumë kolegë më pyesnin, edhe gazetarë më pyesnin, ka shumë raste arrestimesh politikanësh të nivelit të lartë në Rumani. Po këtu, edhe këtu njësor do jetë, edhe ne do kemi raste të tilla, dhe këto kanë ndodhur.

Fakt është që drejtësia shkon deri tek ata që janë lart në pushtet, dhe kjo nuk është dëshmi e një shteti të dobët, por është dëshmi se pushteti politik nuk mund të të ofrojë më imunitet.

Në një sistem ku drejtësia kontrollohet nga politika, prokurorët nuk bëjnë ndjekje penale. Kjo marrëdhënie, drejtësia, reforma në drejtësi e ka ndryshuar. Ky transformim nuk ka qenë as i kollajtë, as i menjëhershëm; ka kërkuar ndryshime kushtetuese që bënë të mundur rindërtimin e institucioneve.

Procesi i vetting ishte sukses, ngritja e strukturave të reja, dhe mbi të gjitha, e pranimit të parimeve themelore demokratike, dhe ka bërë të mundur që politika të mos ketë më kontroll mbi sistemin e drejtësisë. Sot sistemi i drejtësisë i ka kapacitetet të cilat i mungonin për një kohë të gjatë. Ka kapacitetin për t'i

chud i mangonim prej një korrupsioni të gjatë. Na kapërcetm për t'u kundërpërgjigjur keqbërjes dhe për të korrigjuar veten.

Kjo nuk do të thotë që korrupsioni është zhdukur, sigurisht që jo; mbetet si një sfidë dhe një kërcënim me të cilin duhet të përballemi përditë, por dallimi themelor është se korrupsioni sot përballlet me një sistem institucional drejtësie ndryshe, me një sistem që heton më kriminalisht, gjykata që gjykojnë, dhe agjenci që konfiskojnë pasuritë kur plotësohen kërkesat ligjore.

Të gjitha këto duhet të bëhen pavarësisht vullnetit politik.  
Prandaj, mbështetja jonë për institucionet e pavarura të